



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZP.Anr.4/2026

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët Skender Çoçaj - kryesues, Kymete Kicaj dhe Arsim Hamzaj - anëtarë, duke vendosur sipas ankesës së subjektit politik Lista Serbe, me seli në Mitrovicën e Veriut, të paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me Nr.Protokolli 01/810/-2026, të datës 15 Maj 2026, për Miratimin e Rekomandimit për Përbërjen e Këshillave të Vendvotimeve të Rregullta, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, që do të mbahen më 07 Qershor 2026, në seancën e panelit të mbajtur me datë 18.05.2026, merr këtë,

V E N D I M

REFUZOHET E PABAZUAR ankesa ZP.Anr.4/2026, e datës 16.05.2026, e parashtruar nga Subjekti Politik Lista Serbe, me seli në Mitrovicën e Veriut, me të cilën ka kërkuar që të konstatoje se vendimi Nr.01/810-2026 i datës 15.5.2026. për miratimin e rekomandimit për përbërjen e këshillave të rregullta të votimit është i paligjshëm, dhe të urdhërojë Komisionin Qendror të Zgjedhjeve që të miratoj vendimin për miratimin e përbërjes së Këshillave të votimit në vendvotimet e rregullta dhe me kusht, në përputhje me paragrafin 2 të nenit 3 të Rregullores Zgjedhore Nr.11/2024 për Komisionet e Votimit, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 07 Qershor 2026.

A r s y e t i m

Me datë 16.05.2026 PZAP-i ka pranuar ankesën e parashtruar nga subjekti politik Lista Serbe, me seli në Mitrovicën e Veriut, me të cilën pretendojnë se me 15 maj 2026, u miratua vendimi 01/810-2026 për miratimin e rekomandimit për përbërjen e këshillave të votimit në vendvotimet e rregullta, dhe se subjekti politik Lista Serbe nuk është njoftuar zyrtarisht për këtë vendim. Subjekti politik Lista Serbe konsideron se KQZ-ja duke miratuar vendimin 01/810-2026 ka shkelur Rregulloren Zgjedhore nr. 11/2024, përkatësisht nenin 3 paragrafin 2 i cili thotë: "KQZ-ja kujdeset të sigurojë përfaqësim të drejtë në KV, për të gjitha komunitetet, në bazë të: 2.1. Numrit të ndryshëm të popullsisë brenda komunës; 2.2. Numrit të votave të subjekteve politike të secilit komunitet, në nivel vendi dhe në nivel komune." Më tej, subjekti politik Lista Serbe konsideron se KQZ-ja duke miratuar këtë vendim ka shkelur ligjin, përkatësisht nenet 63, 64

paragrafi 2.10, të Ligjit nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë, si dhe nenin 3 të lartcekur të Rregullores Zgjedhore nr. 11/2024 në lidhje me përbërjen e Këshillave të Votimit. Subjekti politik Lista Serbe konsideron se përbërja e këtyre këshillave është jo-legjitime dhe në kundërshtim me ligjin, dhe se disa subjekte politike janë favorizuar, ndërsa subjekti politik Lista Serbe është diskriminuar, pasi i janë dhënë shumë më pak kryesues, anëtarë dhe anëtarë rezervë sesa do të duhej në pajtim me ligjin. KQZ-ja kishte detyrimin t'i caktojë subjektin politik që fitoi më së shumti vota të Komunitetit Serb në zgjedhjet e kaluara, në komunat e përmendura më poshtë. Në krahasim me zgjedhjet e mbajtura më 28 dhjetor 2025, megjithëse Lista Serbe ka arritur rezultat më të mirë dhe ka fituar më shumë vota në këto komuna, dhe numri i partive që janë regjistruar për të marrë pjesë në këto zgjedhje për vendet e rezervuara për komunitetin serb ka mbetur i njëjtë, subjekti ynë politik ka më pak anëtarë dhe kryesues në vendvotime. Parashtruesi i ankesës ka paraqitur të dhëna për komunat lidhur me caktimin e numrit të kryesuesve, anëtarëve si dhe të atyre rezervë, dhe atë për komunën e Leposaviq, Zubin Potok, Zveçan, Mitrovica e Veriut, Graçanicë, Ranillug, Partesh, Kllokot, Shtërpçë dhe Novobërdë. Parashtruesi i ankesës pretendon se Në 28 komuna me shumicë shqiptare, Lista Serbe nuk ka asnjë kryesues, edhe pse në disa vendvotime, votuesit janë ekskluzivisht ose në shumicë dërrmuese serbë, duke potencuar se përvoja nga tre proceset zgjedhore të vitit 2025 tregon se anëtarët e këshillave të votimit të partive shqiptare nuk flasin gjuhën e shumicës dërrmuese të votuesve në komunat me shumicë serbe, prandaj procesi është i ngadalshëm, i vështirë dhe zhvillohet në mënyrë jo mjaftueshëm efikase. Kushdo që synon ta lehtësojë dhe shpejtojë procesin, duhet ta ketë marrë parasysh këtë, veçanërisht duke pasur parasysh se komisionet komunale zgjedhore nuk kanë kryesues në komunat e Mitrovicës së Veriut, Zveçanit dhe Zubin Potokut, kjo ngjall dyshim shtesë në ligjshmërinë e procesit zgjedhor dhe demokracinë në Kosovë. Tutje në ankesë theksohet se me vendime të tilla, po përpiqet të bëhet inxhinieri zgjedhore me të cilën po përpiqet të përjashtohen nga gara zgjedhore përfaqësuesit autentikë serbë, në mënyrë që personat që nuk kanë legjitimitet të vijnë në pozitë të përfaqësojnë komunitetin serb dhe të vihen në pozitë më të favorshme, të paligjshme dhe kundër kushtetuese.

Parashtruesi i ankesës po ashtu thekson se vendime të tilla të paligjshme për përbërjen e këshillave të votimit janë marrë edhe për zgjedhjet e mëparshme parlamentare të mbajtura më 9 shkurt 2025 dhe 28 dhjetor 2025, si dhe për zgjedhjet lokale të 12 tetorit. Prandaj, ne propozojmë që PZAP-ja të marrë një vendim me të cilin do ta anulojë vendimin e paligjshëm dhe antikushtetues të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në përputhje me paragrafin 1 të nenit 53, paragrafin 4 të nenit 131 dhe paragrafin 5 të nenit 132 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, të cilat parashohin si në vijim: *Neni 53. Procedura dhe efektet e anulimit dhe shfuqizimit 1. Një akt administrativ mund të anulohet ose shfuqizohet sipas detyrës zyrtare nga organi publik që ka autoritetin ta miratojë atë, nga organi i tij mbikëqyrës ose nga një organ tjetër i përcaktuar shprehimisht me ligj. Neni 131. Procedura e shqyrtimit të ankesës nga organi publik përgjegjës 4. Kur organi publik përgjegjës vlerëson se ankesa është e pranueshme dhe plotësisht e bazuar, me një akt të ri administrativ anulon ose ndryshon aktin e ankuar, përkatësisht miraton aktin e refuzuar, ashtu siç e ka kërkuar pala. Neni 132. Procedura e shqyrtimit të ankesës nga organi më i lartë 5. Nëse është e nevojshme, organi më i lartë mund*

t'i urdhërojë organit përgjegjës të formulojë aktin që organi më i lartë do ta miratojë, në bazë të udhëzimeve të këtij të fundit.

Për të gjitha sa më sipër dhe në përputhje me nenet 118 dhe 119 të Ligjit nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë, pala ankuese propozon që të konstatojë se Vendimi nr. 01/810-2026 i datës 15.5.2026 për miratimin e rekomandimit për përbërjen e këshillave të rregullta të votimit është i paligjshëm, sepse është në kundërshtim me nenet 63 dhe 64 paragrafi 2.10 të Ligjit nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë, si dhe me nenin 3 të Rregullores Zgjedhore nr. 11/2024, sepse vendimi bazohet në diskriminim të subjektit politik Srpska Lista, dhe të urdhërojë Komisionin Qendror të Zgjedhjeve të miratojë Vendimin për miratimin e përbërjes së Këshillave të Votimit në vendvotimet e rregullta dhe me kusht në përputhje me paragrafin 2 të nenit 3 të Rregullores Zgjedhore Nr. 11/2024 për Këshillat e Votimit.

Në përgjigje në ankesë, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve thekson se pas shqyrtimit të ankesës dhe pretendimeve të palës ankuese në lidhje me kërkesën tuaj ju njofton si në vijim. KQZ bazuar në nenin 74,75,76 dhe 77 të Ligjit nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës si dhe Rregulloren Zgjedhore nr.11/2024 ka miratuar formulën për përbërjen e këshillave të vendvotimit (KVV). Përfaqësimi në KVV 1.1.1. *Subjektet politike të certifikuara, të cilat kanë kaluar pragun zgjedhor në zgjedhjet e fundit nacionale, kanë të drejtë të nominojnë nga një (1) anëtar në KVV. Po ashtu, përfaqësim edhe subjekteve politike të reja të certifikuara për zgjedhje.* 1.1.2. *Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), sipas nevojës, mund ta rrisë ose ta zvogëlojë numrin e anëtarëve të KVV-së deri në dy (2) anëtarë në KVV.* 1.1.3. *KVV reflekton strukturën e anëtarëve të Komisionit Komunal të Zgjedhjeve (KKZ)* 2. Përfaqësimi i komuniteteve në KVV 2.1.1 *Numrin e dallueshëm të popullsisë brenda komunave;* 2.1.2 *Numrin e votave të subjekteve politike të secilit komunitet në nivel vendi dhe në nivel komunal;* 3. KQZ ka vazhduar duke marr për bazë edhe kriteret tjera shtesë: 3.1.1 *KQZ, në bazë të formulës përkatëse, përfshin edhe subjektet politike të përfaqësuara në Kuvendin e Komunës, duke u bazuar në përqindjen e votave të fituara;* 3.1.2 *Nëse nuk arrihet të plotësohet numri prej pesë (5) anëtarësh në KVV, KQZ mund të kërkojë nominime plotësuese nga subjektet politike të certifikuara për zgjedhjet e parakohshme (28 Dhjetor 2025);* 3.1.3 *KKZ ka të drejtë t'i rekomandojë KQZ-së për nominimin e personave me përvojë në proceset zgjedhore, në rast se numri i anëtarëve të KVV-së nuk plotësohet.*

Me qëllim të rritjes së efikasitetit operacional dhe garantimit të një procesi zgjedhor të rregullt dhe të besueshëm përbërja e një Këshilli të Vendvotimit (KVV) bazohet në strukturën standarde dhe orientuese prej pesë (5) anëtarëve, si në vijim: Kryesuesi i KVV-së Kontrolluesi i rreshtit Zyrtari i identifikimit Zyrtari i të dhënave statistikore Dhënësi i fletëvotimit. Me përjashtim të pesë (5) komunave Deçan, Gllogoc, Kaçanik, Malishevë, Hani i Elezit dhe Junik ku numër i përfaqësimit në këtë mekanizëm zgjedhor është katër (4). Ndërsa vetëm në komunën e Prizrenit për shkak të numrit të madh të komuniteteve KQZ ka paraparë rritjen prej gjashtë (6) anëtarë në Këshillat e Vendvotimit.

Në rastin konkret, komuniteti pakicë në Republikën e Kosovës me numrin më të madh të anëtarëve dhe me përfaqësimin më të gjerë në Këshillat e Vendvotimeve (KVV) është komuniteti serb. Subjekti politik më i madh nga komunitetet jo-shumicë, i përfaqësuar në këtë trup zgjedhor, është Lista Serbe. Duke u bazuar në këto elemente, dhe duke marrë parasysh faktin se katër (4) subjektet politike parlamentare të komunitetit shumicë (shqiptar) e kanë kaluar pragun zgjedhor, këtyre subjekteve u takon përfshirja në të gjitha KVV-të. Në këtë kuadër, subjekti me radhë me përfaqësimin më të madh nga komunitetet jo-shumicë është Lista Serbe. Komuniteti serb është i përfaqësuar në 23 komuna përmes dy (2) subjekteve politike: Lista Serbe, dhe Za Slobodu Pravdu i Opstanak. Përfaqësimi sipas subjekteve është si vijon: Lista Serbe, është e përfaqësuar në 23 komuna me 25 kryesues, 189 anëtarë dhe 25 rezerva, gjithsej 239 anëtarë, Za Slobodu Pravdu i Opstanak është e përfaqësuar në 23 komuna me 24 kryesues, 188 anëtarë dhe 22 rezerva, gjithsej 234 anëtarë. Në total, nga komuniteti serb në Këshillat e Vendvotimeve janë: 49 kryesues, 377 anëtarë dhe 47 rezerva, që së bashku përbëjnë 473 anëtarë. Pretendimet se subjekti politik Srpska Lista nuk është njoftuar zyrtarisht nuk qëndrojnë pasi që Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me datë 15.05.2026 rreth orës 17:00, ndërsa subjekti politik Srpska Lista ftesën për nominimin e anëtarëve të Këshillave të vendvotimit të rregullt e ka marrë me datë 16.05.2026 në emailin [redacted] e personit kontaktues [redacted] sikurse të gjitha subjektet tjera politike. (shih njoftimin e bashkangjitur). Pretendimet për diskriminim të komunitetit serb nuk qëndrojnë, pasi ata përbëjnë komunitetin me numrin më të madh të përfaqësuesve në KVV. Parimi i barazisë, sipas legjislacionit në fuqi, zbatohet për të gjitha komunitetet në Republikën e Kosovës, përfshirë komunitetin shumicë dhe komunitetet jo-shumicë. KQZ vlerëson se sipas dispozitave ligjore në fuqi nuk është obligative që numri i anëtarëve në KVV të jetë i njëjte për subjektet politik që vijjnë nga radhët e komuniteteve. Pretendimet e subjektit politik ankues se “Përvoja nga tre proceset zgjedhore të vitit 2025 tregon se anëtarët e këshillave të votimit të partive shqiptare nuk flasin gjuhën e shumicës dërrmuese të votuesve në komunat me shumicë serbe, prandaj procesi është i ngadalshëm, i vështirë dhe zhvillohet në mënyrë jo mjaftueshëm efikase”, nuk qëndrojnë pasi që nga raportet vendore dhe nderkombëtare, si dhe KQZ nuk kanë evidentuar ndonjë parregullsi të kësaj natyre. Gjithashtu pretendimet se KQZ në zgjedhjet vitit 2025 KQZ ka nxjerrur vendime të paligjshme nuk qëndrojnë kjo mund të dëshmohej edhe nga PZAP e cila ankesën Anr.7/2025 të datës 10.12.2025 subjektit politik Srpska Lista ndaj vendimeve të KQZ-së për përbërjen e KVV-ve në zgjedhjet e 28 dhjetorit 2025 e ka hedhur si të pa bazuar. (shih vendimin e bashkangjitur) KQZ siguron se përbërja e KVV sipas formulës reflekton praktikën më të mirë për menaxhimin e një vendvotimi që siguron ndarje të qartë të përgjegjësisë, transparencë dhe rrjedhë të qetë të procesit zgjedhor bazuar në ligj dhe rregulloret përkatëse.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia-PZAP, pas shqyrtimit të ankesës dhe shkresave të lëndës, pretendimeve ankimore, përgjigjes në ankesë, gjeti se:

- Ankesa është e pabazuar.

Sipas vlerësimit të Panelit pretendimet ankimore të parashtruesit të ankesës se vendimi i KQZ-së, me Nr.protokolli 01/810-2026, i datës 15.05.2026, për Miratimin e Rekomandimit për

Përbërjen e Këshillave të Vendvotimeve të Rregullta, lidhur me mos emërimin e drejtë të anëtarëve të tyre nga radhët e subjektit politik Lista Serbe janë të pabazuara.

Me nenin 77 paragrafi 5 i ligjit Nr.08/L-228, përcaktohet se *"Kundër vendimit të KQZ-së për mos emërimin kryesuesit dhe anëtarëve të vendvotimit, subjektet politike dhe palët tjera me interes juridik mund të paraqesin ankesë në PZAP, brenda 48 orëve nga shpallja e vendimit nga KQZ."* Po ashtu me nenin 77 paragrafi 3 i Ligjit Nr.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme, përcaktohet *"Kryesuesit e këshillave të vendvotimeve zgjidhen në mënyrë të barabartë në mesin e katër (4) subjekteve politike të certifikuara që kanë fituar numrin më të madh të votave për Kuvendin e Kosovës gjatë zgjedhjeve të fundit në atë komunë"*. Ndërsa paragrafi 4, i po të njëjtit nen parasheh që *"Pavarësisht paragrafit paraprak të këtij neni, në rast se kërkohet, KQZ-ja ka kompetenca për të emëruar sipas zgjedhjes së saj anëtarët e KKV-ve, të cilët nuk përmbushin kushtet sipas këtij neni"*.

Ndërsa në nenin 3 paragrafi 2 të Rregullores Zgjedhore Nr.11/2024, për Këshillat e Vendvotimeve përcaktohet se *"KQZ kujdeset që të sigurojë përfaqësimin e drejtë në KVV, për të gjitha komunitetet, duke u bazuar në: 2.1. Numër të dallueshëm të popullatës brenda një komune; 2.2. numrin e votave të subjekteve politike të secilit komunitet, në nivel vendi dhe në nivel komunal"*.

Andaj bazuar në dispozitat e sipërcituara ligjore Paneli ka gjetur se nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të parashtruesit të ankesës se me rastin e marrjes së vendimit nga KQZ, nuk janë respektuar dispozitat ligjore nga neni 65 dhe 64 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme, si dhe nenin 3 paragrafi 2 të Rregullores Zgjedhore Nr.11/2024 për Këshillat e Vendvotimeve, kjo për faktin se me rastin e përcaktimit të numrit për përbërjen e Këshillave të Vendvotimeve të Rregullta dhe me Kusht, ka zbatuar në tërësi dispozitat ligjore në fuqi duke marrë parasysh rezultatet zgjedhore të fundit dhe renditjes së subjekteve politike, përfshirë edhe subjektin politik ankues. Kjo pasi që subjektin politik Lista Serbe i është dhënë përfaqësim nga ana e KQZ në 23 komuna me 25 kryesues, 189 anëtarë dhe 25 rezerva, gjithsej 239 anëtarë.

Mbi këtë bazë Paneli konstaton se KQZ-ja, me rastin e marrjes së vendimit drejt ka zbatuar dispozitën ligjore të sipërcituara, pasi që subjekti politik Lista Serbe është i përfaqësuar në KVV në pajtim me këto dispozita dhe në bazë të Formulës për emërimin e KVV-ve.

Gjithashtu nuk qëndron edhe pretendimi për diskriminimin e komunitetit serb, kjo pasi që KQZ ka vepruar drejtë lidhur me përfaqësimin e komuniteteve, pasi që përfaqësimi i komunitetit serb përbëjnë komunitetin me numrin më të madh të përfaqësuesve në KVV, dhe është i përfaqësuar në 23 komuna, me 25 kryesues, 189 anëtarë dhe 25 rezerva, gjithsej 239 anëtarë, duke marrë për bazë se në nenin 3 paragrafi 1 të Rregullores 11/2024 për Këshillat e Vendvotimeve ndër të tjera përcaktohet se *"...se KQZ kujdeset që të sigurojë përfaqësimin e drejtë në KVV për të gjitha komunitetet duke u bazuar në numrin e dallueshëm të popullatës brenda një komune dhe numrin e votave të secilit komunitet në nivel vendi dhe në nivel komunal"*.

Ndërsa sa i përket pretendimit lidhur atë se disa subjekte politike janë favorizuar, ndërsa subjekti politik Lista Serbe është diskriminuar me këtë vendim dhe se KQZ-ja ishte e detyruar ti caktonte subjektit politik që ka fituar numrin më të madh të votave të komunitetit serb në komunat e sipërcituara, Paneli vlerëson se sipas dispozitave ligjore në fuqi nuk është obligative që numri i anëtarëve në KVV, të jetë i njëjtë për subjektet politike që vijnë nga radha e komuniteteve.

Sa i përket pretendimit se subjekti politik Lista Serbe nuk është njoftuar zyrtarisht për vendimin 01/810-2026 për miratimin e rekomandimit për përbërjen e këshillave të votimit në vendvotimet e rregullta, PZAP gjen se ky pretendim është i pa bazuar ngase KQZ në përgjigjen në ankesë ka ofruar dëshmi përkatësisht se subjekti politik Srpska Lista ftesën për nominimin e anëtarëve të Këshillave të vendvotimit të rregullt e ka marrë me datë 16.05.2026 në emailin [redacted] e personit kontaktues [redacted] sikurse të gjitha subjektet tjera politike.

Duke marrë parasysh të lartpërmendurat, Paneli vlerëson se parashtuesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse, edhe pse në bazë të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në të cilin nen në mënyrë të qartë përcakton se *"Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse."* Prandaj, duke u mbështetur në nenin 117.3 të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla të palës ankuese janë të paqëndrueshme dhe si të tilla i refuzoi të pabazuara.

Prandaj, nga arsyet e parashtuara më lart bazuar në nenin 117.3 dhe 119.3 të Ligjit Nr.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, dhe nenit 13 paragrafi 2 të Rregullores, së PZAP-it Nr.01/2025, për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

ZP.Anr.4/2026, datë 18.05.2026



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.